



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

KKT miraton Planin Vendor për bashkitë Tiranë, Përrenjas e Dibër.

2017-04-14 19:24:00



Këshilli Kombëtar i Territorit nën drejtimin e Kryeministrit, Edi Rama miratoi sot, Planin e Përgjithshëm Kombëtar të 3 bashkive: Tiranë, Dibër dhe Përrenjas, duke e çuar kështu në 19 numrin e bashkive që kanë të miratuar planet e tyre vendorë.

Kryeministri Rama në fjalën e tij i cilësoi Planet e Përgjithshme Vendorë si një moment të rëndësishëm për të gjitha bashkitë që hyjnë në rrugën e qytetërimit europian për vizionin urban të së ardhmes.



“Përmes Planit të Përgjithshëm që miratojmë sot (Tr 030), pas disa vitesh, Tirana do të jetë kryeqyteti me hapësirën më të madhe për këmbësorët në Europën Juglindore. Plani i vjetër parashikonte një Tiranë me një popullsi më të madhe se popullsia e Shqipërisë, por nuk parashikonte shërbime të tjera përveçse shërbime në qendër të Tiranës. Një dokument i spekulimit imobilar, më irracional që besoj mund të gjendet në historinë e Europës. Dhe fatmirësisht ky dokument nuk u vu dot në jetë dhe sot merr jetë një model krejtësisht i ri, i ndërhyrjeve të mirëmenduara. **Një plan që ndryshe nga planet klasike, është një adoptim i inteligjencës së territorit duke shfrytëzuar më së miri potencialet e territorit**”

dhe duke mirëkuptuar traditën, kohën e zhvillimit dhe mendësinë në këtë territor. Është një plan për qytetin dhe për 1 milion e 500 mijë qytetarët e vitit 2030", deklaroi Kryeministri. Ministrja e Zhvillimit Urban Eglantina Gjermeni, duke folur për ecurinë e hartimit dhe miratimit të Planeve të Përgjithshme Vendore theksoi se deri në fund të këtij viti 43 bashki nga 61 do të kenë të miratuara PPV, të cilat garantojnë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit të këtyre bashkive, në respektim dhe mbrojtje të tokës, mjedisit dhe trashëgimisë kulturore, i ofrojnë qytetarëve dhe sipërmarrësve siguri dhe rritje të vlerës së investimit për qytetarët dhe sipërmarrësit.



grupeve të interesit, ekspertëve të huaj dhe vendas, botës akademike, të cilët ishin pjesë e këtij procesi prej nga fillimi”, tha Ministrja Gjermani.

Kryebashkiaku Veliaj pak përpara miratimit të PPV për Tiranën nënvizoi se **pavarësisht se ky plan u puna dhe u miratua në një kohë rekord, pas më shumë se 100 seancash dëgjimore, nuk do ta humbë cilësinë, edhe gjatë zbatimit të tij.**



Plani i Përgjithshëm Vendor për bashkinë Tiranë u hartua nga UNLAB, Stefano Boeri Architetti, IND në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë.

Ky plan sugjeron zhvillimin e planeve specifike të sektorit për projekte si:

- Projekti strategjik 01 – Metrobosco

Arritja e një rripi prej 2 milionë pemësh përreth qytetit, që do të bëjnë të mundur bllokimin e shfrytëzimit të tokës dhe krijimin e një unaze me pyje produktive, parqe të pyllzuara dhe pyjeve për natyralizim.

- Projekti strategjik 03 – Unaza e dytë dhe e katërt të gjelbra

Arritja e dy unazave të gjelbra dhe të qendrueshme, parqeve lineare dedikuar kembësoreve, ciklizmit dhe levizshmerise se bute (soft-mobility).

- Projekti strategjik 04 – Parku i Botes i ri dhe bulevardi

Arritja dhe forcimi i palces se metropolitkaleidoskopik duke zgjeruar Bulevardin

Deshmoret e Kombit deri tek Parku i Botes.

- Projekti strategjik 05 – Korridoret blu dhe të gjelbër

Transformimi i rrjedhes se ujit - edhe kur ato rrjedhin ne pjesen e brendshme te qytetit - ne korridoret ekologjike te rigjenerimit dhe biodiversitetit.



- Projekti strategjik 07 – Një rrjet i ri dhe i gjerë i shkollave të hapura – qyteti publik
 Arritja e një rrjeti të ri dhe shkollave të hapura, të cilat do të jenë të hapura në çdo orë të ditës dhe natës dhe do të shërbejnë si vende qendrore dhe qendra qytetare në lagje.
- Projekti strategjik 08 – Ruajtja e trashëgimisë së shekullit të XX
 Atribuon ndërtesave që kanë deshmuar historinë intensive gjeopolitike të shekullit XX një vlerë të trashëgimisë kolektive, të cilat do të respektohen dhe theksohen.
- Projekti strategjik 09 – Korridore bujqësore dhe tregje për fermerët
 Forcimi i funksionit bujqësor në luginën e lumit Erzen dhe luginave të degeve të tij duke krijuar një rrjet të përhapur të agroturizmit, fermerit, dhe vendet e prodhimit
- Projekti strategjik 10 – 11 – Sistemi i lëvizshmërisë
 Arritja e një rrjeti të shpejtë të hekurudhor duke lidhur qendrën e qytetit me aeroportin dhe portin. Plotesimi i rrjetit të transportit publik në qendrën e qytetit me një Linjë Rrethore përgjatë Unazës së Katërtë dhe linjës së transportit publik përgjatë Bulevardit Deshmorët e Kombit.
- Projekti strategjik 12 – Tirana për të gjithë - Qytet i Aksesueshëm
 Realizimi i një metropoli të qëndrueshëm për të gjithë - sidomos për qytetarët e ndjeshëm (te moshuarit, fëmijet, njerezit me aftësi të kufizuara). Stimulon mobilitetin e përbashkët (biciklete, makina, etj) dhe mënyrën e transportit të qëndrueshëm (elektrike dhe transportuesit hibride) në mënyrë që të sigurojnë një lëvizshmëri ekologjike për qytetarët.
- Projekti strategjik 13 – Korridori energjitik

Realizimi përgjatë luginës Elbasan-Krrabë një sistem të integruar prodhimi bujqësor, magazinim dhe shpërndarja e energjive të rinovueshme. Për përmbushjen e këtyre objektivave në 15 vite propozohen 13 projekte strategjike të zbatueshme në afatin e shkurtër, të mesëm dhe të gjatë, si dhe 30 politika të përgjithshme, të bazuara në 5 sisteme metabolike (mjedis, infrastrukturë, hapësirë urbane, bujqësi dhe ujë.